

**Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë
me Përgjegjësi të Kufizuar "ARON TECHNOLOGY SYSTEMS Shpk "**

- "Ligji" është Ligji nr. 9901 , datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë.

**KAPITULLI I
Formimi , Emri , Objekti , Kohëzgjatja dhe Selia Ligjore**

**Neni 1
Data e themelimit , Emri dhe Themeluesit**

1. Sot më 10.10.2023, une, themelusi, kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin " ARON TECHNOLOGY SYSTEMS " Sh.p.k., e cila rregullohet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe sipas këtij Statuti.
 2. Themeluesi i shoqërisë eshte :
- **Elson Lulo** , i lindur në Mazhan më 08-03-1984,dhe banues ne durres identifikuar me Leternjoftimin Nr. 038931147 dhe Nr. Personal I40308111N ,madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë si më poshtë:

"Veprimtari në fushën e teknologjis se Informacioni dh sherbimeve IT "

Objekti i shoqerise eshte zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i produkteve ose sherbimeve inovative me vlerë te larte teknologjike dhe me konkretnisht:

kryesisht zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e asistences se një sherbimi inovativ te menaxhimit te magazines se kantiereve dhe zhvillimit tregtar nepermjet zhvillimit te softuerit te brendshem dhe/ose personalizimit dhe perpunimit te softuerit te paleve te treta dhe/ose krijimit te aplikacionet ad-hoc. Ky sherbim eshte inovativ pasi bashkon një seri inteligjencë artificiale dhe/ose mjete me burim te hapur per t'i lejuar perdoruesit, bazuar ne historikun e shfletimit dhe operacionet historike, një pervoje zgjidhese te problemit me te cilin perballët dhe eshte me vlerë te larte teknologjike pasi bazohet ne algoritme te sofistikuara te mesimit te makinerive, sistemet e rekomandimeve dhe minierat e te dhenave (machine learning, recommendation systems, data mining).

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu aktivitetet e meposhtme dytesore pervec asaj kryesore:

- zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i platformave online, aplikacioneve celulare ose mjetete te tjera te internetit ne per gjithesi, duke perfshire mundesine e transferimit (per shembull me licence) te teknologjive pronesore te mbrojtura ne perputhje me legjislacionin aktual per pronesine intelektuale dhe industriale;
- zhvillimin, prodhimin dhe marketingun e zgjidhjeve SEO dhe sherbimeve per zhvillimin, pozicionimin dhe promovimin e faqeve te internetit dhe aplikacioneve celulare;



- zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i zgjidhjeve harduerike dhe softuerike ne fushat e TIK, Internetit te Gjerave (Internet of Things (IoT) dhe robotikes;
- zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i platformave te te dhenave te medha (big data platform), d.m.th. platformave per analizen e pergjithshme te te dhenave, per shembull per te lehtesar te kuptuarit permes gjenerimit te automatizuar te statistikave dhe grafikeve;
- zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e sherbimeve te IT dhe telematike;
- zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i aplikacioneve VoIP, softuereve qe perdonin algoritme te intelijences artificiale, harduerit dhe softuerit dhe sherbimeve te bazuara ne logjiken e "ekonomise se ndarjes" ("sharing economy");
- zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e sherbimeve te promovimit dhe reklamimit ne format dhe metodat e ndryshme te lejuara me ligj, duke perfshire banderola, lidhje ne internet dhe forma te tjera te marketingut ne internet;
- zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e sherbimeve te IT, telematike, marketingu, trajnimi dhe mbeshtetjeje logjistike per zhvillimin e tregtise tradicionale dhe elektronike, si nepermjet internetit ose rrjeteve te tjera telematike, ashtu edhe nepermjet kanaleve tradicionale;
- mbledhjen, perpunimin, publikimin dhe shitjen e informacionit ne lidhje me veprimtarine dhe sjelljen e perdoruesve;
- tregtia me pakice dhe shumice e programeve kompjuterike, harduereve, mobiljeve, veshjeve, ushqimeve dhe çdo kategorie tjeter merceologjike te menaxhuar kryesisht nepermjet sistemeve elektronike dhe IT;
- menaxhimin e faqeve te internetit, platformave te internetit dhe rrjeteve sociale per qellime informative dhe tregtare qe synojne kryesisht kompanite qe prodhojne mallra ose sherbime, bleres dhe te apasionuar pas softuereve, harduereve, mobiljeve, veshjeve, si dhe te produkteve ose sherbimeve te tjera;
- asistence teknike, konsulencje dhe trajnim ne lidhje me produktet dhe sherbimet e lartpermendura;
- organizimi i nismave kulturore, shkencore dhe informative, nepermjet ekspozitave reklamuuese (perfshire online), panaireve tregtare, kurseve (perfshire online), perhapje e librarive dhe multimedias, perqatitjes dhe krijimit te dokumenteve ne lidhje me promovimin e nje kulture te re te teknologjive te informacionit nepermjet web-i dhe problemet qe lidhen me eksperimentimin dhe prodhimin ne fushat me interes per shoqerine.

Keto aktivitete mund te kryhen drejtperdrejt ose me urdher te paleve te treta ose nepermjet koordinimit te thjeshte tekniko-financiar te ofruesve te puneve dhe sherbimeve.

Shoqeria mund te perfundoje dhe te kryeje te gjitha operacionet dhe çdo akt te nevojshem, te dobishem ose te pershatshem per zbatimin e qellimit te shoqerise dhe, ne kete menyre, nder te tjera:

operacionet e pasurive te paluajtshme, tregtare, industriale, bankare dhe hipotekore, duke perfshire blerjen, shitjen, kembimin dhe, ne per gjithesi, tjetersimin e pasurive te luajtshme, duke perfshire ato te regjistruala, te drejtat e pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme, financimin me institucione, banka, kompani dhe individe private duke dhene garancite e duhura reale dhe personale, pjesemarrjen ne konsorciume, me veprimtari te brendshme dhe te jashtme, marrien e aksioneve apo interesave te çdo lloji ne shoqeri apo biznese te tjera qe kane nje objekt te ngjashem, te perafert apo te lidhur me tonin, te gjitha brenda kufijve te legjpcionit ne fuqi ne ate kohe.

Ne per gjithesi, blerja e aksioneve, ashtu si te gjitha ato aktivitete te klasifikuara si "financiare", mund te kryhen vetem ne nje menyre thjesht instrumentale ne lidhje me ndjekjen e qellimit te shoqerise sic u pershkrua me siper dhe ne çdo rast ato nuk mund te marrin ato konotacione ne baze te te cilave, ne baze te dispozitave perkatese ne fuqi, aktivitete te tilla klasifikohen si te rezervuara per subjektet e autorizuara ne menyre specifike per t'i kryer ato.

Neni 3 Kohëzgjata

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar (pa afat).

Neni 4 Selia

(1) Selia ligjore e shoqërisë është në adresën **Durres Rrashbull Shkallnur Ndertes me nr pasurie 196/8 zona kadastrale 3385 .**

KAPITULLI II KAPITALI

Neni 5 Kapitali Themelues

(1) Kapitali fillestari i regjistruar i shoqërisë është 100 000(Njëqindmije) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themelor të shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si vijon:

1. Ortaku themelues **Elson Lulo** : Zotëruar i 100 (njëqind) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 Lekë, që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë;

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (të luajtshme / të pasurive të paluajtshme apo të të drejtave). Ortakët e kanë shlyer kapitalin në përputhje me përqindjen e kapitalit, në para.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit në pëpruthje me ligjin në fuqi.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojen për ndryshimin e statutit.
Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
Në çdo rast do të aplikohen parashikimet ligjore përkatëse.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Nëse një prej ortakëve vundos të tjetërsojë kuotat në palë të treta, ai fillimisht duhet t'i mundësojë ortakut tjetër të shoqërisë të drejtë e parablerjes.

Në rastin e parablerjes, ortaku që dëshiron të tjetërsojë kuotat duhet të njoftojë me shkrim ortakun tjetër duke i njoftuar çmimin e si dhe palën blerëse. Ortaku që gëzon të drejtën e parablerjes, brenda 90 ditëve nga marrja e njoftimit, do të njoftojë për ushtrimin ose jo të së drejtës të parablerjes. Në rast mos-përgjigje nga ortaku që ka të drejtën e parablerjes, me kalimin e 90 ditëve nga njoftimi, ortaku që dëshiron të tjetërsojë kuotën mund ta kryejë lirisht.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KAPITULLI III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërise. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modalitetave të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shpërndarja e fitimit vjetor;
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqruar ndryshimet në të dhënat e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimitarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.



2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte deri në 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të Ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pese vjeçare): **Erion Sulejmani** i lindur në Permet më 06-08-1979 dhe banues ne Durres, identifikuar me Leternjoftimin Nr.034621127 dhe Nr.Personal H90806072U madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqerinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 Përgjegjësitë e administratorit



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoquerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoquerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kapitulli IV Viti finanziar-ekspertet

Neni 16 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 17



Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V Prishja–riorganizimi i shoqërisë

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në perputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**O R T A K Ē T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ARON TECHNOLOGY SISTMS"**

ELSON LULO



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Elson Lulo".

